



Drejtuar:

Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve (KAS), pranë Komisionit Qëndror tënr. Zgjedhjeve

Objekti:

Kundërshtimi i vendimit nr. 1326, datë 24.05.2025 "Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025"; Rinumerimin dhe/ose rivlerësimi i votave në të gjitha KZAZ-t e Qarkut Tiranë; Ndryshimi i rezultatit të tabelave përmbledhëse pas rinumerimit dhe/ose rivlerësimit të votave.

Të nderuar,

Në kundërshtim të Vendimit nr. 1326, datë 24.05.2025 "Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025" kërkoj rinumërimin dhe rivlerësimin e votave preferenciale të kandidatëve. Kjo nisur nga konstatimi në videot e marra, jo të plota, nga KQZ, të procesit të numërimit të votave të zgjedhësve. Konkretisht, në KZAZ nr. 28, kutia 1565, konstatoj se disa vota preferenciale të miat janë regjistruar në emër të një kandidati tjetër. Sipas informacioneve, ky fenomen ka ndodhur edhe në KZAZ të tjera, duke tjetërsuar rezultatin e zgjedhjeve. Procesi i verifikimit të pamjeve filmike kërkon një kohë të gjatë, të cilën KQZ duhet të na e mundësojë në mënyrë që ligji të zbatohet dhe vullneti i zgjedhësve të lexohet plotësisht.

Përsa më sipër, kërkoj rivlerësimin e votave të kandidatëve për të gjitha KZAZ e Qarkut Tiranë.

Kandidati për Deputet i ASHM-PD

Lisander Hoxha

mob: 0689026 486